



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

---

Prishtinë, më 29 janar 2013  
Nr. ref.: AGJ 367/13

## **AKTGJYKIM**

në

**Rastin Nr. KO09/13**

**Konfirmim i amendamentit të propozuar kushtetues, të paraqitur nga Kryetari  
i Kuvendit të Republikës së Kosovës, më 18 janar 2013, nëpërmjet shkresës  
Nr. 04-DO-1357**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

## Hyrje

1. Më 22 qershor 2012, Kryetari i Kuvendit të Kosovës dorëzoi kërkesën e parë (Rasti Nr. KO 61/12) në Gjykatën Kushtetuese përkitazi me propozimin e Qeverisë për amendamentet kushtetuese, duke kërkuar vlerësim nëse amendamentet e propozuara nga Qeveria pakësojnë ndonjë nga të drejtat dhe liritë e parapara me Kapitullin II të Kushtetutës.

2. Më 31 tetor 2012, Gjykata Kushtetuese vendosi:

“..

- Njëzëri

I. *Kërkesa e parashtruar nga Kryetari i Kuvendit, më 22 qershor 2012, me amendamentet e propozuara të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është e pranueshme;*

- Me shumicë

II. *Amendamenti 1 i propozuar – Amnistia, paragrafi i parë, përkitazi me “**personat e cekur me emër**”, pakëson të drejtat dhe liritë e njeriut, të parapara me Kapitullin II të Kushtetutës;*

- Njëzëri

III. *Amendamenti 1 i propozuar – Amnistia, paragrafi i dytë dhe i tretë, nuk pakësojnë të drejtat dhe liritë e njeriut, të parapara me Kapitullin II të Kushtetutës;*

*Amendamenti 2 i propozuar – Neni 108 [Këshilli Gjyqësor i Kosovës] i Kushtetutës nuk pakëson të drejtat dhe liritë e njeriut, të parapara me Kapitullin II të Kushtetutës.*

....”

3. Më 17 dhjetor 2012, Kryesia e Kuvendit (Vendimi Nr. 04-P-124/k), në bazë të nenit 67.6 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkyetarëve] të Kushtetutës, që parasheh se “*Kryetari dhe nënkryetarët formojnë Kryesinë e Kuvendit. Kryesia është përgjegjëse për funksionimin administrativ të Kuvendit në mënyrën e përcaktuar me Rregulloren e Punës të Kuvendit*”; të nenit 82 [Procedurat për amendamentin e Kushtetutës] të Rregullores së Kuvendit, që parasheh se “*1. Qeveria, Presidenti ose një e katërta (1/4) e deputetëve, sipas Rregullores së Kuvendit, mund ta propozojnë amendimin e Kushtetutës. 2. Çdo amendim e kërkon miratimin e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve të Kuvendit, përfshirë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve të Kuvendit, që mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve, që nuk janë shumicë në Republikën e Kosovës*”; si dhe të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në Rastin Nr. KO61/12, nxori përfundimin të kërkojë nga Qeveria e Republikës së Kosovës që, në cilësinë e propozuesit, të bëjë riformulimin e propozimit të Amendamentit I në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, që ka të bëjë me amnistinë, në pajtim me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, Nr. KO61/12.

4. Më 11 janar 2013, Zëvendëskryeministri dhe Ministri i Drejtësisë i ka përcjellë Kryeministrit, z. Hashim Thaçi, propozimin për amendamentim kushtetues për futjen e Amnistisë si kompetencë e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në përputhje me udhëzimet e Gjykatës Kushtetuese, sipas Aktgjykimit AGJ303/12 përkitazi me propozimin për futjen e Amnistisë si kategori kushtetuese. Për me tepër, Zëvendëskryeministri dhe Ministri i Drejtësisë kanë informuar Kryeministrin, z. Hashim Thaçi, që Ministria e Drejtësisë do ta përgatisë edhe një ligj të përgjithshëm për amnistinë, ku do të sqaroheshin procedurat për miratimin e ligjeve përkatëse për dhënien e amnistisë, përjashtimet, si dhe mënyra e realizimit të saj më pas.
5. Më 16 janar 2013, Qeveria e Republikës së Kosovës, “në bazë të nenit 92.4 të Kushtetutës, që parasheh se *“Qeveria merr vendime në pajtim me këtë Kushtetutë dhe me ligje, propozon projektligje dhe amendamentimin e ligjeve ekzistuese e akteve të tjera, si dhe mund të japë mendimin rreth projektligjeve të cilat nuk janë të propozuara nga ajo”*; në bazë të nenit 93.4 të Kushtetutës, që parasheh se *“merr vendime dhe nxjerr akte juridike ose rregullore, të nevojshme për zbatimin e ligjeve”*; si dhe në bazë të nenit 144.1 të Kushtetutës, që parasheh se *“Qeveria, Presidenti ose një e katërta (1/4) e deputetëve të Kuvendit, sipas Rregullores së Punës të Kuvendit, mund të propozojnë ndryshime dhe amendamente të kësaj Kushtetute”*, ka miratuar Vendimin Nr. 01/113 për aprovimin e propozimit të Ministrisë së Drejtësisë për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Propozimet e Qeverisë për amendamentimin e Kushtetutës).
6. Më 18 janar 2013, Kryetari i Kuvendit të Kosovës i ka dorëzuar Gjykatës “amendamentin e propozuar nga Qeveria e Kosovës në Kushtetutën e Republikës së Kosovës (...) për të vlerësuar nëse ndryshimi i propozuar nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës”.

### **Baza juridike**

7. Kërkesa bazohet në nenin 113.9 dhe në nenin 144.3 të Kushtetutës, në nenin 20 dhe në nenin 54 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

### **Procedura në Gjykatë**

8. Më 18 janar 2013, Kryetari i Kuvendit të Kosovës i referoi Gjykatës Kushtetuese propozimin e Qeverisë për amendamentin kushtetues, duke kërkuar vlerësim nëse amendamenti i propozuar nga Qeveria pakëson ndonjë nga të drejtat dhe liritë e parapara me Kapitullin II të Kushtetutës.
9. Më 25 janar 2013, Kryetari caktoi gjyqtarin Altay Suroy Gjyqtar raportues dhe caktoi Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Almiro Rodrigues (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Ivan Čukalović.
10. Më 25 janar 2013, Kryetari i Kuvendit u informua se Gjykata kishte regjistruar kërkesën.
11. Po të njëjtën ditë, nga një kopje e kërkesës iu dërgua Presidentes së Republikës së Kosovës, Kryeministrit të Republikës së Kosovës dhe Avokatit të Popullit.
12. Më 29 janar 2013, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit Altay Suroy, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.

### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

13. Gjykata shqyrton nëse janë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

14. Neni 113.9 i Kushtetutës, thotë:

*“Kryetari i Kuvendit të Kosovës duhet të referojë amendamentet kushtetuese të propozuara para miratimit në Kuvend, me qëllim që të konstatohet nëse amendamenti i propozuar i zvogëlon të drejtat dhe liritë e garantuara me kapitullin II të Kushtetutës”.*

15. Gjykata vëren se Kryetari i Kuvendit paraqiti kërkesë për vlerësim paraprak të amendamentit të propozuar të Kushtetutës, kështu që, në bazë të nenit 113.9 të Kushtetutës, Kryetari i Kuvendit është palë e autorizuar për ta referuar këtë rast në Gjykatë.

### **Shtrirja e konfirmimit kushtetues**

16. Kryetari i Kuvendit paraqiti një (1) amendament të propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

17. Konfirmimi i kushtetutshmërisë së amendamentit të propozuar, nga ana e kësaj Gjykate, nuk bëhet duke marrë parasysh vetëm të drejtat dhe liritë e njeriut që përfshihen në Kapitullin II, por edhe gjithë shkronjën dhe frymën e rendit kushtetues të Republikës së Kosovës, siç sqarohet më tepër nga paragrafi 56 e deri te paragrafi 71, të Aktgjykimit të nxjerrë më 20 korrik 2012, në rastet KO29/12 dhe KO48/12 (Amendamentet e propozuara të Kushtetutës nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, më 23 mars 2012 dhe më 4 maj 2012).

### **Kushtetutshmëria e amendamentit të propozuar kushtetues**

#### **Amendamenti 1 i propozuar: Amnistia**

18. Amendamenti 1 propozon që nenit 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës t'i shtohet paragrafi i ri 15, i cili do të thotë:

*“(15) jep amnisti me ligj përkatës i cili miratohet me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit”.*

19. Prandaj, amendamenti i propozuar sugjeron që, në kompetencën ekzistuese të Kuvendit, të shtohet një kompetencë e re, përkatësisht të shtohet kompetenca për të dhënë amnisti me ligj përkatës, i cili do të miratohet me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.

20. Gjykata konsideron se ndryshimi i propozuar është në pajtim me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese në Rastin Nr. KO61/12. Gjykata, po ashtu, konfirmon se amendamenti i ri i propozuar nuk pakëson të drejtat dhe liritë e njeriut, të parapara me Kapitullin II të Kushtetutës.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në bazë të nenit 113.9 dhe nenit 144.3 të Kushtetutës, në bazë të nenit 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe në bazë të rregullit 56 (1) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 29 janar 2013, njëzëri

## VENDOSI

- I. Kërkesa e parashtruar nga Kryetari i Kuvendit, më 18 janar 2013, që përmban amendamentin e propozuar të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është e pranueshme;
- II. Amendamenti 1 i ri i propozuar – Amnistia, neni 65, paragrafi 15, i Kushtetutës, nuk pakëson të drejtat dhe liritë e njeriut, të parapara me Kapitullin II të Kushtetutës;
- III. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe,
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**

**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Altay Suroy



Prof. dr. Enver Hasani

